



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**  
**-Shërbimi i kuvendit-**

**01Nr.60/03-11816/20**  
**Kaçanik, 17.06.2020**

### **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja **II-të (Dytë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete për vitin 2020, mbajtur me datë 17 Qershor 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Kuvendit të Komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin të gjithë 7 anëtarët: Lirije Luta-PDK, Kaltrina Tafili-LVV, Nazife Krasniqi-LDK, Hajredin Luta-AAK, Elmihane Krasniqi-Malsiu-HANDIKOS, Shemsedin Abazi nga KMLDNJ dhe Naim Hysa nga Kryqi i Kuq.

Nga Ekektivi i Komunës mori pjesë Drejtori i Administratës, z.Festim Neziraj dhe Drejtoresha e DSHMS-së, znj.Diana Reka.

Mbledhjen e kryesoi Lirije Luta, Kryesuese e Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtës: Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

**znj.Lirije Luta**, Fillimisht përshëndes të pranishmit dhe hapi mbledhjen e II-të (dytë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, data 17 qershor, me këtë :

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete e vitit 2020;
2. Diskutim rreth monitorimit të të drejtave të qytetarëve të kthyer nga diaspora;
3. Diskutim rreth gjendjes së Pandemisë Covid -19; dhe
4. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete e,

### **APROVOJ**

**Rendin e punës, në përbërje prej 4 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;

Procesverbali i mbledhjes se II(Dytë) të rregullt të Komitetit për Komunitete i vitit 2020, u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete e,

### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes se I (parë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2020, të datës 26.02.2020 / Lënda : 01Nr.60/01-5450/20.**

## 2. Diskutim rreth monitorimit të të drejtave të qytetarëve të kthyer nga diaspora

**znj. Lirije Luta,** Kemi pasur aktivitet rreth çështjes së të kthyerve nga diaspora , nëse keni diçka për diskutim ,urdhëroni.

**Znj.Kaltrina Tafili,** Kam pyetje rreth aktivitetit që keni zhvilluar sepse nuk kam marrë pjesë.

**znj. Lirije Luta,** Kemi vizituar zyrën për kthim dhe komunitete, dhe na kanë njoftuar rreth personave të kthyer. Sipas Shefit të zyrës për kthim dhe komunitete , komuna nuk ka organizuar diçka . Ka mungesë të hapësirave për vendosjen e personave të kthyer dhe është edhe çështja ekonomike. Zyra për kthim ka thënë se do të bëjë një raport lidhur me gjendjen e të kthyerve nga diaspora.

**Znj.Nazife Krasniqi,** Në zyrën për kthim dhe komunitete na njoftuan se deri në vitin 2016, personat e kthyer kanë përfituar deri në 3000 euro. Mirëpo rregullorja kishte ndryshuar dhe kishin ndryshuar edhe kriteret. Personat e kthyer kanë ndjekur trajnime të ndryshme dhe kanë marrë certifikata. Mirëpo në komunën tonë nuk kanë marrë për shkak të kriterëve , vetëm dy persona kanë përfituar. Deri në vitin 2016 në komunën tonë janë dhënë 100 mijë euro për personat e kthyer. Ku kanë shkuar ato mjete?

Në vitin 2019 janë kthyer 8 familje ndërsa në vitin 2020 vetëm 1 familje.

**z.Naim Hysa,** Kam qenë pjesë e projektit për kthim të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Deri në vitin 2019 ka pasur persona të kthyer por nuk kanë pasur interesim të regjistrohen. Personat e kthyer nga Kryqi i Kuq kanë përfituar pako ushqimore për 3 muaj. Është dashur të bëhet nga një plan biznesi për të përfituar nga projekti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo qytetarët e kthyer nuk kanë shprehur interesim. Nga zyra për kthim dhe komunitete e komunës tonë , janë përkrahë familjet dhe personat e kthyer nga diaspora dhe kanë qenë të njoftuar për projektin. Komunitete tjera nuk ka pasur të kthyer.

**Znj.Nazife Krasniqi,** Nuk dihet numri i nënave vetushqyese të kthyer nga diaspora.

**Znj.Elmihane Krasniqi,** Deri në cilin vit kanë përfituar familjet dhe personat e kthyer nga diaspora?

**z.Naim Hysa,** Në vitin 2017, mirëpo kriteret kanë qenë të ashpra. Është dashur të bëjnë një plan biznesi, por nuk kanë ditur dhe nuk kanë përfituar. Planet janë vlerësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

**Znj.Elmihane Krasniqi,** Nëse nuk kanë përfituar atëherë fajtor është komuna që nuk i kanë ndihmuar të bëjnë një plan biznesi.

**z.Naim Hysa,** Përkrahje morale dhe ideore kanë pasur nga komuna, mirëpo ata kanë dashur të marrin pare kesh. Kanë mund të përfitojnë lopë ose pajisje tjera por nuk kanë pasur interes.

**znj. Lirije Luta**, Edhe sa i përket çështjes së punësimit , ata vet nuk kanë pranuar.

**z.Naim Hysa**, Të gjithë e kanë pasur pa pagesë të kryejnë kurse të ndryshme në qendrën e trajnimeve në Ferizaj, por nuk kanë pasur interes. Në momentin që kanë ardhur në aeroportin e Prishtinës , janë futur në sistem si të kthyer dhe i janë dhënë broshurat për të drejtat e të riatdhesuarve. Edhe ne si komision kemi qenë në teren dhe i kemi vizituar dhe i kemi thënë të aplikojnë për projekte, por nuk ishin të interesuar.

**z.Hajredin Luta**, Falënderoj z.Naim Hysa për informatat sepse kemi menduar që është mungesë e informimit nga institucionet për këta persona. Për ata personat që kanë përfituar nga projektet a kanë pasur sukses?

**z.Naim Hysa**, Nuk jam në dijeni.

### 3.Diskutim rreth gjendjes së Pandemisë Covid-19

**znj. Lirije Luta**, Falënderoj Kryetarin dhe gjithë shtabin emergjent për punën e kryer gjatë pandemisë Covid-19. A keni ndonjë pyetje?

**Znj.Diana Reka**, Nëse keni ndonjë pyetje ju jap sqarimet.

**znj. Lirije Luta**, A janë testuar familjarët e rastit të parë , të familjes Berisha në fshatin Runjevë.

**Znj.Diana Reka**, Janë testuar gjithë familja e ngushtë dhe familja e gjerë dhe 6 persona nga kjo familje kanë dal pozitiv. Tani kemi një rast në fshatin Gabrricë dhe një rast në familjen Matluma në Kaçanik. Janë testuar edhe persona të tjerë por ende nuk kemi rezultate. Informatat e sakta dalin në web faqen e QKMF-së dhe web faqen e Komunës.

**Znj.Kaltrina Tafili**, Sa i përket rastit të parë në fshatin Rekë, çka ka ndodh me at rast, a është shëruar?

**Znj.Diana Reka**, Rasti në fshatin Rekë ka pas probleme ortopedike dhe ka qenë në spital dhe aty i është bërë analiza, ka dal pozitiv. Familjarët e saj janë testuar dhe kanë dalë negativ.

**z.Shemsedin Abazi**, Sa janë duke u respektuar masat?

**Znj.Diana Reka**, Inspektori sanitar gjatë gjithë kohës është në teren, mirëpo të gjithë jemi dëshmitar që nuk po respektohen masat.

**z.Shemsedin Abazi**, Ne si klub i futbollit “Lepenci” e kemi objektin dhe na është kërkuar që së pari të dezinfektohet , para se me filluar stërvitjet.

**Znj.Diana Reka,** Bëni kërkesë në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës dhe bëjmë zgjidhje. Janë dezinfektuar të gjitha institucionet, banesat, xhamit etj.

**Znj.Kaltrina Tafili,** Sa i përket QKMF-së , personi i infektuar nga fshati Runjevë, ka thënë se nuk i është dhënë ndihma nga QKMF. Çfarë masa keni ndërmarrë?

**Znj.Diana Reka,** Personi në fjalë ka qenë në QKMF në Ferizaj, dhe aty nga mjeku i është kërkuar të shkoj në spital sepse ka dyshuar se është i infektuar me virusin Covid-19. Mirëpo ky person i ka fsheh dokumentet dhe 4 ditë ka marrë infuzione në QKMF në Kaçanik, me çrast e ka rrezikuar gjithë stafin dhe qytetarët tjerë. Ditën e 4 –të i është keqësuar gjendja dhe nuk ka pasur staf të mjaftueshëm në ndërrimin e natës dhe mjeku nuk e ka parë të arsyeshme për dërgim urgjent në spital. Gjatë gjithë kohës sa ka qenë familja në izolim stafi i QKMF-së i kanë ofruar ndihmën e nevojshme.

**z.Shemsedin Abazi,** Sa i përket Pandemisë Covid-19, Komuna e ka menagjuar mirë situatën sipas mundësive. Rasti konkret është fajtori kryesor për fshehjen e dokumenteve dhe virusit Covid-19.

**znj. Lirije Luta,** Ankesat e qytetarëve dhe mendimet e tyre bazohen në rrjetet sociale, siç është në facebook faqja “S’je Kaqanikli nëse”. Dikush duhet ta mbikëqyr këtë faqe sepse shpesh postojnë dezinformata.

**Znj.Diana Reka,** Informatat e sakta kanë qenë në web faqen e Komunës dhe kanë qenë 3 numra të telefonave për ndihmë qytetarëve në kohën e Pandemisë Covid-19.

**z.Naim Hysa,** Shtabi komunal çdo ditë kanë dal me komunikatë. Në mbledhje të shtabit kanë marrë pjesë të gjitha partitë politike. Nga Kryqi i Kuq gjithsej janë shpërndarë: 2.465 pako ushqimore, mbi 1.315 thasë miell dhe 350 pako higjienike.

**Znj.Kaltrina Tafili,** Është dashur më herët të reagojnë ndaj këtyre faqeve.

**z.Naim Hysa,** Sipas policisë duhet që të ngritët padi nga një person ndaj faqes në fjalë.

**Znj.Elmihane Krasniqi,** Sipas drejtoreshës në QKMF ka automjete por nuk ka shoferë. A keni bërë ndonjë planë nëse kthehet prape virusi Covid-19?

**Znj.Diana Reka,** Ka pasur edhe vullnetarë për shoferë, mirëpo ne kemi staf që i dërgojmë edhe në pikat kufitare. Kemi bërë kërkesë për staf shtesë nga Ministria e Shëndetësisë.

**Znj.Nazife Krasniqi,** Sa i përket çështjes së testeve, a mund të bëhen në privat?

**Znj.Diana Reka,** Nuk i kam këto informata, se kushdo nuk mund t’i bëjë këto teste.

**Znj.Kaltrina Tafili,** Për personat që vijnë nga shtetet e huaja, a po testohen?

**Znj.Diana Reka**, Personat që vijnë nga shtetet e huaja, i bëjnë testet nga vendet që udhëtojnë dhe kur të vijnë këtu Ministria i urdhëron të rrijnë në vet izolim.

**znj. Lirije Luta**, personat që kanë sëmundje kronike, në rast se kanë simptome të virusit Covid-19, a do t'i bëhet testi?

**Znj.Diana Reka**, Nëse kanë simptome, lajmërohen në QKMF dhe i bëhet testi.

**znj. Lirije Luta**, Falënderojmë drejtoreshën për informatat dhe e lirojmë nga mbledhja.

#### 4.Të ndryshme

**Znj.Kaltrina Tafili**, Kërkojë që të mbikëqyret faqja në facebook "S'je Kaqanikli nëse", sepse shumë shqetësohen qytetarët.

**z.Hajredin Luta**, Edhe unë i bashkëngjitëm kërkesës së parafolësës. Kërkoj që ne si Komitet për Komunitete të ngrisim zërin , të takohemi me policinë që të merren me rastin në fjalë.


**Znj.Elmihane Krasniqi**, Ndoshta nuk është vetëm faji i tij, sepse edhe personat tjerë i japin informata.

**Znj.Kaltrina Tafili**, Nuk është fjala vetëm për dezinformata por edhe raste të tjera. Ka raste kur i jep lajmet për aksidente , mirëpo nuk jep detaje të aksidentit.

**z.Naim Hysa**, Ne edhe me polici edhe me inspektorin sanitar duhet të bëjmë kërkesë për me i ndal takimet publike, tubimet publike.

**znj. Lirije Luta**, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:10.

Procesmbajtës  
Arbnora Kuka



Kryesuese e Komitetit  
Lirije Luta

